



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.112

24 korrik

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.675, datë 18.6.2009	Për hapjen e filialit të universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, në qytetin e Pogradecit 5399
Vendim i KM nr.682, datë 11.6.2009	Për miratimin e minimumit të specifikimeve teknike të pajisjeve të lotarisë kombëtare 5399
Vendim i KM nr.686, datë 18.6.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës 5402
Vendim i KM nr.687, datë 18.6.2009	Për përcaktimin e nivelit të firove të lejuara gjatë procesit të përpunim-manipulimit të duhanit 5403
Vendim i KM nr.690, datë 18.6.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Tepelenë 5404

VENDIM
Nr.675, datë 18.6.2009

**PËR HAPJEN E FILIALIT TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË, NË QYTETIN
E POGRADECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 11, 25, 26 e 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Pogradecit, të filialit të Fakultetit të Ekonomisë, në programin e studimit të ciklit të parë, për “Turizëm”.
 2. Ky program studimi të realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është tri vite akademike.
 3. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të parë “Turizëm”, përftohet “Diplomë e nivelit të parë” DNP në “Turizëm”.
 4. Ky filial do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2009-2010.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.682, datë 11.6.2009

**PËR MIRATIMIN E MINIMUMIT TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË PAJISJEVE TË
LOTARISË KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pajisjet e lotarive kombëtare, për të qenë të ligjshme për përdorim, duhet të përmbushin specifikimet teknike, sipas këtij vendimi. Asnjë pajisje nuk do të përdoret nga i licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare, nëse ajo nuk është certifikuar dhe miratuar si pajisje nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.
2. I licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare duhet të ketë sistem qendror kompjuterik, i cili duhet të plotësojë këto kushte:
 - a) Mundësinë për të kryer kontrollin e këtij sistemi;
 - b) Mundësinë për kryerjen e kontrollit të sigurisë;
 - c) Mundësinë për të kryer kontroll financiar.Sistemi qendror duhet të jetë një sistem kompjuterik, me kapacitet të mjaftueshëm (për përpunim të dhënash, memorie, ndërfaqe komunikimi, hardisk të ruajtjes së të dhënave), për të performuar, në mënyrë efektive, të gjitha detyrat, që lidhen me realizimin e procesit të lotarisë.
3. Mjedisi, ku do të vendoset sistemi qendror kompjuterik, duhet të jetë i siguruar. Personat, që kanë të drejtë të hyjnë në këtë mjedis, duhet të jenë të pajisur me autorizimin përkatës, të lëshuar nga i licencuari për veprimtarinë e lotarisë. Gjithashtu, i licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare duhet

të sigurojë një sistem monitorimi elektronik të hyrje/daljeve të personelit.

4. Të gjitha pajisjet e sistemit qendror, si dhe pajisjet e tjera (sistemi i ndriçimit, i kondicionimit, sistemi telefonik), të vendosura në dhomën e kompjuterave, duhet të furnizohen, në mënyrë të pandërprerë, me energji dhe të jenë të pajisura me sistem tokëzimi.

5. I licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare nuk mund të ndërhyjë në sistemin qendror kompjuterik apo në komponentët e tij dhe të sistemit të hardware-it dhe të software-it pa miratimin e Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

6. Serveri qendror duhet të gjenerojë dhe të transmetojë në terminale konfiguracionin dhe të dhënat për:

- a) Ndryshimin e kreditit;
- b) Numrat e rastësishëm;
- c) Komponentët e rezultateve të lojërave, p.sh. topa, letra, pozicionet e ndalimit të rrotës;
- ç) Rezultatit aktual të lojës;
- d) Përditësimet e matësit të krediteve për lojërat e fituara.

Serveri dhe терминаlet duhet të kenë antivirus të përshtatshëm, ndërsa i licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare duhet t'i ketë të gatshme procedurat për zbulim dhe mbrojtje nga viruset, nëse ekziston mundësia e infektimit.

7. Të gjithë softwar-et e të gjithë komponentëve të sistemit qendror duhet të ruhen sipas një sistemi të përshtatshëm kontrolli, të versionit të software-ve.

8. Të gjitha pajisjet, ku ruhen programet, përfshi ROMs, EPROMs, FLASH ROMs, DVD, CD-ROM, Compact Flash dhe çdo pajisje tjetër, të cilat nuk duhet të ndryshojnë gjatë funksionimit të serverit, duhet të kenë të shënuar qartësisht një informacion të mjaftueshëm për identifikimin e softit dhe nivelin e rishikimit të informacionit të ruajtur në pajisje.

9. I licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare lejohet të përdorë *software*-in, versioni i të cilit është miratuar nga DPM-ja. Nëse i licencuari kërkon ndryshimin e *software*-it, ky ndryshim duhet të reflektohet në kodin e burimit të këtij software-i.

Të gjitha të dhënat, si dhe çdo e dhënë për ngjarjet e sigurisë, ruhen jo më pak se 2 (dy) vjet, në rastin e ngjarjeve të veçanta, dhe jo më pak se 5 (pesë) vjet, për të dhënat financiare.

10. Sistemi funksional i *file*-ve dhe i *database*-ve duhet të jenë të mbrojtur me *password* si dhe duhet të ruajnë historikun e hyrje-daljeve në kompjuter. *Password*-et duhet të jenë individuale për të gjithë personat e autorizuar. I licencuari i lotarive duhet të mbajë një regjistër për ndryshimet eventuale të *password*-eve të tyre.

Për të siguruar besueshmërinë dhe integritetin e sistemit qendror, të gjitha *file*-t duhet të jenë të dubluara.

Në rast dëmtimi apo shkatërrimi (p.sh. nga zjarri) të sistemit qendror, i licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare duhet të sigurojë një mënyrë për rikthimin e të dhënave.

11. Të gjitha kodet dhe *password*-et e përdorura nga i licencuari për lotari duhet të jenë të koduara në formë të patjetërsueshme. Çelësat e kodimit dhe të dekodimit duhet të kodohen në formë të kthyeshme.

Në rastet kur lojtarët dhe personeli i të licencuarit për veprimtarinë e lotarisë kombëtare identifikohen me numër personal identifikimi "PIN", atëherë algoritmi, që gjeneron numrat PIN, si dhe procedura përkatëse e ndryshimit, ruajtjes së bazës së të dhënave, sigurisë dhe shpërndarjes së PIN-it, duhet të jenë të testuara nga DPM-ja, përpara miratimit nga NJMLF-ja.

12. Konfigurimi i një *hardware*-i të sistemit qendror miratohet nga NJMLF-ja. Besueshmëria, rikthimi i të dhënave dhe siguria e konfigurimit të *hardware*-it testohen nga DPM-ja.

13. I licencuari për lotari duhet të dorëzojë dy kopje të ilustrimeve, skemave, diagramave, analizës së qarqeve, manualeve teknike dhe të funksionimit pranë DPM-së, për analizimin dhe testimin e terminalit të videolotarisë dhe të pajisjeve shoqëruese. Në rast se procesi i testimit kërkon çmontim të terminalit dhe nëse gjatë çmontimit mund të dëmtohen komponentët elektronikë të tij, atëherë i licencuari për veprimtarinë e lotarisë kombëtare/prodhuesi duhet të depozitojë në DPM pajisje të specializuara për të testuar terminalin e prodhuar dhe përdorur prej tij.

Terminali duhet të sigurojë mbrojtje nga shkarkesat elektrostатike, për të cilat kërkohet që kasa përçuese e terminalit të jetë e tokëzuar, në mënyrë, që këto shkarkesa të mos e dëmtojnë apo pengojnë punën normale të terminalit. Testet do të kryhen me një minimum niveli sigurie prej 27 KV shkarkesë ajrore.

Nuk duhet të ketë asnjë mundësi që nga terminalet të ndërhyhet në konfiguracionin e serverit.

14. Çdo pajisje lojërash fati duhet të ketë të ngjitur një target, i cili të përmbajë:

- a) të dhëna për prodhuesin;
- b) një numër serial unik;
- c) modelin e pajisjes së lojës së fatit;
- ç) datën e prodhimit.

15. Të gjitha aparatet, që shërbejnë për lojërat e fatit, duhet të sigurojnë që të mos ketë humbje të të dhënave pas një ndërprerjeje të energjisë. Lidhja dhe komunikimi me aparatet e sistemet e tjera nuk duhet të ndikojë, në asnjë rast, në faktet dhe rezultatet e lidhura me lojërat e fatit, të propozuara nga automati.

16. Të gjitha aparatet, që shërbejnë për lojërat e fatit, duhet të sigurojnë që tokëzimi i aparatit të jetë më i vogël se 4 omh. Kryerja e testit ka të bëjë me sigurinë e jetës së lojtarit gjatë lojës.

17. Të gjitha aparatet, që shërbejnë për lojërat e fatit, duhet të sigurojnë që kohëzgjatja e një loje të jetë më e madhe se 1 sekondë.

18. Të gjitha pajisjet, ku ruhen programet, përfshi ROMs, EPROMs, FLASH ROMs, DVD, CD-ROM, Compact Flash, dhe çdo pajisje tjetër për ruajtje të dhënash, duhet të jenë markuara me informacionin e mjaftueshëm, për të identifikuar software-in dhe nivelin e informacionit të ruajtur në to.

Software-i i pajisjeve të lojërave të fatit duhet:

a) T'i sigurojë lojtarit paraqitjen vizuale të informacionit të mëposhtëm, për gjendjen aktuale të lojës:

- i) betin;
- ii) planin e fitimeve;
- iii) kredinë;
- iv) fitimin;
- v) rezultatit aktual të lojës;
- vi) xhekpotin ose bonusin (shpërblimin suplementar), në rastet kur pajisja konkrete e parashikon këtë.

b) Të garantojë përputhje ndërmjet mjeteve të drejtimit të zonës së kontaktit të lojtarit dhe funksionimin e tyre sipas rregullave.

c) Të garantojë përputhje ndërmjet kredive të aplikuara në automatet e lojërave të fatit dhe informacionit për këto kredi në sistemin e drejtimit, në pajisjen për kontroll të pjesshëm dhe në sistemin e paraqitjes vizuale.

ç) Të ruajë informacionin për kreditë e aplikuara dhe të paguara, të paktën 1 500 h (orë) pas ndërprerjes së energjisë elektrike.

Në rast se *software-i* i automateve të lojërave regjistron ndonjë gabim të programbajtësit ose në kujtesën, që varet nga energjia elektrike, atëherë ai duhet ta ndërpresë lojën dhe t'i dërgojë njoftim sistemit të paraqitjes vizuale.

19. Pajisjet e lojërave të fatit duhet të kenë, të paktën, katër numërorë elektromekanikë, të cilët sigurojnë informacionin e mëposhtëm:

- a) Totalin e kredive të aplikuara (total in);
- b) Totalin e kredive të paguara (total out);
- c) Totalin e kredive të luajtura (total bet);
- ç) Totalin e kredive të fituara (total win).

Matësit elektromagnetikë duhet të regjistrojnë të dhëna të njëjta si matësit elektronikë. Çdo numëror duhet të ketë të paktën 6 radhë, treguesit duhet të ndryshojnë vetëm në drejtim të rritjes, të mos zerohen me ndërhyrje nga jashtë dhe secili të ketë shenjë për destinacionin e tij të punës.

Në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike, pajisja për kontroll të pjesshëm duhet të ruajë informacionin, të paktën 1 500 orë.

20. Sistemi i sinjalizimit jep shenja zanore dhe/ose vizuale me dritë, në rast se ndodhin ngjarjet e mëposhtme:

- a) Hapja e derës së kabinës;
 - b) Fitimi i shumës, e cila i kapërcen mundësitë e automatit për pagesë të drejtpërdrejtë;
 - c) Fitimi i xhekpotit, në rast se automati parashikon një gjë të tillë;
- Një direktori e programit duhet të regjistrojë të gjitha ngjarjet e mësipërme.

21. Zona e kontaktit për pjesëmarrje në lojë i siguron pjesëmarrësit në lojë:

a) informacion të qartë dhe të njëkuptimshëm;

b) mundësi zgjedhjeje të të gjitha parametrave të parashikuara në rregullat e lojës.

Vetëm persona të autorizuar mund të kontrollojnë parametrat e konfiguracionit të lojës dhe të dhënat statistikore, brenda kufijve të përcaktuar nga prodhuesi.

22. Zona e autorizuar e kontaktit lejon përdorimin e të dhënave statistikore të lojës, vetëm nga persona të autorizuar, të cilët mund të kontrollojnë parametrat e konfiguracionit të lojës dhe të të dhënave statistikore, brenda kufijve të përcaktuar nga prodhuesi.

23. Pajisja e pranimit të kredive lejon aplikimin e kredisë vetëm me mjetet dhe sipas mënyrës së parashikuar nga prodhuesi.

Pajisja për pagesë duhet të garantojë përputhje ndërmjet kredisë efektive dhe kredisë së paguar.

24. Pajisjet e lojërave të fatit duhet t'u përgjigjen kërkesave brenda kufijve të lejueshëm të shmangies së parametrave të rrjetit elektrik.

25. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.686, datë 18.6.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E DREJTËSISË, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Shkenca juridike civile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

b) Doktoratë në “Shkencat penale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

c) Doktoratë në “E drejta publike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

2. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën 3 vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

3. Kuotat e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, për vitin 2009, janë, gjithsej, 30, prej të cilave 4 për kandidatët nga jashtë kufijve të vendit. Ndarja e këtyre kuotave, sipas programeve të studimeve, është, si më poshtë vijon:

a. Doktoratë në “Shkenca juridike civile”, 10 kuota;

b. Doktoratë në “Shkencat penale”, 10 kuota;

c. Doktoratë në “E drejta publike”, 10 kuota.

4. Mënyra e plotësimit të kuotave, që mbeten të paplotësuara në një program studimi, përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Tarifa e shkollimit për çdo program të plotë studimi është 400 000 (katërqind mijë) lekë dhe likuidohet, për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me kështu të caktuara nga fakulteti përkatës. Kandidatët, që do të ndjekin programet e studimit të doktoratës, nga stafi akademik i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë, paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.687, datë 18.6.2009

PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË FIROVE TË LEJUARA GJATË PROCESIT TË PËRPUNIM-MANIPULIMIT TË DUHANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe të neneve 16 e 25 të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbeturinat e pashfrytëzuara, që krijohen në proceset e magazinimit, të përpunim-manipulimit të duhanit, si dhe humbjet e lëndës së thatë, si pasojë e shndërrimeve biokimike gjatë fermentimit, përbëjnë atë që quhet firo e lejuar.

Në procesin e përgatitjes së duhanit për treg, firot krijohen gjatë:

a) ruajtjes në magazinë;

b) përpunim-manipulimit dhe përgatitjes së tongave;

c) fermentimit.

a) Firo të lejuara gjatë ruajtjes në magazinë janë humbjet nga:

- procesi natyral i fermentimit;

- dëmtimet mekanike, në rrotullimin e dengjeve, për efekt ajrosjeje (allaburi);

- myku i gjetheve të duhanit.

b) Firo të lejuara gjatë përpunim-manipulimit janë humbjet:

- gjatë ventilimit të gjetheve (largim të lëndëve inerte);

- nga dëmtimet mekanike, gjatë seleksionimit dhe përpunimit të duhanit;

- nga dëmtimet mekanike, gjatë bërjes së tongave.

c) Firo të lejuara gjatë fermentimit janë humbjet:

- për efekt të procesit artificial të fermentimit;

- nga dëmtimet mekanike, gjatë përpunimit të tongave para, gjatë dhe pas fermentimit.

2. Niveli i firove të lejuara gjatë proceseve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për duhanet e tipit “Oriental” është si më poshtë vijon:

a) Gjatë ruajtjes në magazinë deri 2.5%;

b) Gjatë përpunim-manipulimit deri 5.3%;

c) Gjatë fermentimit deri 3.2%;

ç) Gjithsej deri 11%.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.690,datë 18.6.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
LEVAN-TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, (kultura bujqësore dhe drufrutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Tepelenë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për kultura bujqësore 6 167 053 (gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e tre) lekë dhe për drufrutorë 2 801 990 (dy milionë e tetëqind e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë, me sipërfaqe të përgjithshme 293 072 (dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e dy) m². Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 8 969 043 (tetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e tre) lekë.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 3 450 000 (tre milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 8 969 043 (tetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e tre) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë në qershor 2009 dhe të përfundojë më 31.8.2009.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA TOTALE E FSHTRAVE QE PREKEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRURE-FRUTORE

Nr	FSHTRAT	EMERTIMI			SIPERFAQE m2	VLERA TOTALE
		KULTURA BUJQESORE	DRURE FRUTORE			
1	SHEQ MUSALAJ	361600	0		14527	361600
2	FRAKULL EVOGEL	321620	0		17461	321620
3	BUZMADH	242329	0		24184	242329
4	VRESHTAZ	31254	0		3457	31254
5	GJONÇ	47586	72000		7768	119586
6	GORISHOVE	141727	59390		18523	201117
7	ROMES	60100	12800		9095	72900
8	VARIBOBE	274439	0		27648	274439
9	VJOSE	132193	0		12197	132193
10	KLOS	25000	123000		1748	148000
11	BEJAR	246600	94400		9954	341000
12	MALAS	99500	415200		5832	514700
13	LEVAN	66280	217350		7017	283630
14	FRAKULL E MADHE	1190800	120000		33043	1310800
15	PESHTAN BREGAS	286820	0		6925	286820
16	KAFARAJ	1057860	740000		23329	1797860
17	ADE	1137520	675000		36663	1812520
18	MOLLAJ	197900	0		16322	197900
19	ZHULAJ	38375	0		2231	38375
20	KRAHES I SIPERM	1500	0		107	1500
21	KRAHES I POSHTEM	17110	0		2020	17110
22	LULEZIM	71330	216000		3625	287330
23	TOÇ	108150	0		6289	108150
24	VASJAR	9460	55500		3091	64960
25	ILIRAS	0	1350		16	1350
	Shuma (Leke)	6167053	2801990		293072	8969043

Ministria e Puneve Publike, Transp. Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektori i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJESORE DHE DRUFROTORE

QARKU FIER KOMUNA :FRAKULL Fshati:Sheq Musalalaj

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona	Nr. i	Sip	Kul.Bujq	Dru Frutore	Totali Lek	Shenime
1	Isuf	Haxhi	Lalaj	3356	125/4	1104	22000	0	22000	Konf.Z.R.P.P
2	Petrit	Isuf	Lalaj	3356	125/5	942	32000	0	32000	Konf.Z.R.P.P
3	Xhezmi	Dule	Lalaj	3356	125/6	1374	28000	0	28000	Konf.Z.R.P.P
4	Rexhep	Ramiz	Lalaj	3356	125/7	1365	28000	0	28000	Konf.Z.R.P.P
5	Besim	Ramiz	Lalaj	3356	125/8	1098	36000	0	36000	Konf.Z.R.P.P
6	Qemal	Ramiz	Lalaj	3356	125/9	855	17000	0	17000	Konf.Z.R.P.P
7	Malio	Siht	Lalaj	3356	125/10	715	14400	0	14400	Konf.Z.R.P.P
8	Fatmir	Musa	Lalaj	3356	125/11	630	12600	0	12600	Konf.Z.R.P.P
9	Qani	Musa	Lalaj	3356	125/12	613	12400	0	12400	Konf.Z.R.P.P
10	Mustafa	Siht	Lalaj	3356	125/13	537	17200	0	17200	Konf.Z.R.P.P
11	Tafil	Siht	Lalaj	3356	125/15	567	18000	0	18000	Konf.Z.R.P.P
12	Zenun	Shefit	Lalaj	3356	125/16	724	23200	0	23200	Konf.Z.R.P.P
13	Muharrem	Zenun	Lalaj	3356	125/17	158	5200	0	5200	Konf.Z.R.P.P
14	Aslan	Qazim	Lalaj	3356	125/18	410	13200	0	13200	Konf.Z.R.P.P
15	Xhevat	Qazim	Lalaj	3356	125/20	1135	36400	0	36400	Konf.Z.R.P.P
16	Luto	Qazim	Lalaj	3356	125/21	580	11600	0	11600	Konf.Z.R.P.P
17	Namik	Sadik	Lalaj	3356	125/23	1720	34400	0	34400	Konf.Z.R.P.P
Shuma (Leke)						14527	361600	0	361600	

Ministria e Puneve Publike, Transp.Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektori i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFROTORE

QARKU FIER KOMUNA :FRAKULL Fshati:Frakull e Vogel

Nr	Emert	Atesia	Mbiemri	Zona	Nr. i . Pasurise	Sip Shpr.m2	Kul.Bujq		Dru Frutore		Shenime
							Vlera Lek	Vlera Lek	Vlera Lek	Totali Lek	
18	Idai	Ferma	Loloja	1635	115/48	340	6000	0	0	6000	Konf.Z.R.P.P
19	Ferman	Asllan	Loloja	1635	115/47	416	1660	0	0	1660	Konf.Z.R.P.P
20	Halit	Asllan	Loloja	1635	115/46	868	28000	0	0	28000	Konf.Z.R.P.P
21	Agur	Ashar	Loloja	1635	115/45	692	14000	0	0	14000	Konf.Z.R.P.P
22	Zino	Ashar	Loloja	1635	115/44	426	8600	0	0	8600	Konf.Z.R.P.P
23	Hakim	Islam	Guma	1635	115/41	327	6000	0	0	6000	Konf.Z.R.P.P
24	Avni	Islam	Guma	1635	115/40	333	1340	0	0	1340	Konf.Z.R.P.P
25	Shaqet	Maliq	Guma	1635	115/39	378	6800	0	0	6800	Konf.Z.R.P.P
26	Islam	Maliq	Guma	1635	115/38	609	10800	0	0	10800	Konf.Z.R.P.P
27	Novruz	Dane	Duka	1635	115/37	232	920	0	0	920	Konf.Z.R.P.P
28	Tetem	Dane	Duka	1635	115/36	277	8800	0	0	8800	Konf.Z.R.P.P
29	Sabri	Haxhi	Kacaku	1635	115/35	521	9200	0	0	9200	Konf.Z.R.P.P
30	Bafjar	Shyqeri	Kacaku	1635	115/34	462	8400	0	0	8400	Konf.Z.R.P.P
31	Adem	Shyqeri	Kacaku	1635	115/33	225	4000	0	0	4000	Konf.Z.R.P.P
32	Shyqiri	Haxhi	Kacaku	1635	115/32	518	10000	0	0	10000	Konf.Z.R.P.P
33	Brahim	Hysen	Metaja	1635	115/31	676	3400	0	0	3400	Konf.Z.R.P.P
34	Skender	Islam	Kalaja	1635	115/29	520	10000	0	0	10000	Konf.Z.R.P.P
35	Brahush	Islam	Kalaja	1635	115/28	283	9200	0	0	9200	Konf.Z.R.P.P
36	Selim	Islam	Kalaja	1635	115/27	284	5200	0	0	5200	Konf.Z.R.P.P
37	Ferko	Brahim	Pashaja	1635	115/26	956	18000	0	0	18000	Konf.Z.R.P.P
38	Pasho	Brahim	Pashaja	1635	115/25	899	16000	0	0	16000	Konf.Z.R.P.P
39	Shpetim	Kujtim	Pashaja	1635	115/23	274	8000	0	0	8000	Konf.Z.R.P.P
40	Gjysho	Shpetim	Kacaku	1635	115/21	989	18000	0	0	18000	Konf.Z.R.P.P

41	Shkelqim	Sherif	Kacaku	1635	115/20	625	12000	0	12000	Konf.Z.R.P.P
42	Dino	Sherif	Kacaku	1635	115/18	692	12800	0	12800	Konf.Z.R.P.P
43	Veli	Baro	Kacaku	1635	115/17	654	2600	0	2600	Konf.Z.R.P.P
44	Rushit	Xhelal	Gjojdeshi	1635	115/16	1138	22800	0	22800	Konf.Z.R.P.P
45	Ymer	Sulo	Goga	1635	115/15	622	12400	0	12400	Konf.Z.R.P.P
46	Viktor	Isamil	Goga	1635	115/14	73	300	0	300	Konf.Z.R.P.P
47	Ismail	Sulo	Goga	1635	115/13	641	12000	0	12000	Konf.Z.R.P.P
48	Luan	Xhemil	Goga	1635	115/12	188	6000	0	6000	Konf.Z.R.P.P
49	Zari	Isuf	Goga	1635	115/9	268	8800	0	8800	Konf.Z.R.P.P
50	Ceno	Isuf	Goga	1635	115/8	317	5600	0	5600	Konf.Z.R.P.P
51	Nace	Bego	Goga	1635	115/7	402	7200	0	7200	Konf.Z.R.P.P
52	Vidir	Isuf	Goga	1635	115/6	336	6800	0	6800	Konf.Z.R.P.P
Shuma (Leke)						17461	321620	0	321620	

Republika e Shqiperise
Ministria e Puneve Publike, Transp.Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektor i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFROTORE

QARKU: FIER KOMUNA :CAKRAN Fshati Buzmadh

Nr	Emeri	Atesia	Mbiemri	Zona		Nr. i Pasurise	Sip Shpr.m2	Kul.Bujq		Dru Frutore		Shenime
				Kadastrale				Vlera Lek		Vlera Lek		
1	BILBIL	QAZIM	LAMCE	1341		206	549	5435		0		Konf.Z.R.P.P
2	SULO	QAZIM	LAMCE	1341		213	414	3726		0		Konf.Z.R.P.P
3	RESMI		LAMCAJ	1341		233	377	3732		0		Konf.Z.R.P.P
4	HEKURAN	REXHEP	LAMCE	1341		221	250	2475		0		Konf.Z.R.P.P
5	BILBIL	QERIM	BENDAJ	1341		209	303	2999		0		Konf.Z.R.P.P
6	FAIK	IZET	LAMCE	1341		234	178	1762		0		Konf.Z.R.P.P
7	BILBIL	QERIM	BENDAJ	1341		229	70	693		0		Konf.Z.R.P.P
8	FERRIK	QAMIL	BENDAJ	1341		224	217	2148		0		Konf.Z.R.P.P
9	QEMAL	HARELIN	MERDANI	1341		282	1446	14315		0		Konf.Z.R.P.P
10	HAXHI	NEIM	YMERI	1341		297	1571	15553		0		Konf.Z.R.P.P
11	QANI	LIKO	YMERI	1341		304	413	4088		0		Konf.Z.R.P.P
12	ZYNI	TEMO	MUSARAJ	1341		354	411	4069		0		Konf.Z.R.P.P
13	FECORR	HAJDAR	IDRIZI	1341		338	698	6910		0		Konf.Z.R.P.P
14	KASTRIOT	SHYQO	IDRIZI	1341		303	625	6187		0		Konf.Z.R.P.P
15	SHYQO	HAJDAR	IDRIZI	1341		316	407	4029		0		Konf.Z.R.P.P
16	FEJZI	GJYSHO	IDRIZI	1341		330	84	832		0		Konf.Z.R.P.P
17	TEKI	MYRHO	SULAJ	1341		569	193	1910		0		Konf.Z.R.P.P
18	QEREM	MYRHO	MUSARAJ	1341		803	796	7880		0		Konf.Z.R.P.P
19	LUAN	SHAHIN	MUSARAJ	1341		769	1201	11890		0		Konf.Z.R.P.P
20	JETNOR	SHAHIN	MUSARAJ	1341		823	961	9513		0		Konf.Z.R.P.P
21	HARELIN	SAKO	MUSARAJ	1341		894	329	3257		0		Konf.Z.R.P.P
22	METO		MERDANI	1341		1076	14	139		0		Konf.Z.R.P.P

23	AXHEM	DANO	MERDANI	1341	1152	774	7663	0	7663	Konf.Z.R.P.P
24	AXHEM	DANO	MERDANI	1341	1159	855	8464	0	8464	Konf.Z.R.P.P
25	ILIRJAN	GJYSHO	KAFILI	1341	1211	2583	25571	0	25571	Konf.Z.R.P.P
26	BARJAM	LIKO	LICAJ	1341	2126	798	7900	0	7900	Konf.Z.R.P.P
27	FERJAT	SABRI	LICAJ	1341	2138	1613	15969	0	15969	Konf.Z.R.P.P
28	TEMO	RRAPO	LICAJ	1341	2135	849	8405	0	8405	Konf.Z.R.P.P
29	JETNOR	MERSIN	BENDAJ	1341	2143	829	8207	0	8207	Konf.Z.R.P.P
30	AGUR	RRAPO	LICAJ	1341	2136	323	3287	0	3287	Konf.Z.R.P.P
30	NEIM	DERVISH	YMERI	1341	1017	2984	29541	0	29541	Konf.Z.R.P.P
31	BASHKIM	NEIM	YMERI	1341	1053	1392	13780	0	13780	Konf.Z.R.P.P
	Shuma (Leke)					24507	242329	0	242329	

Ministria e Puneve Publike, Transp.Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektor i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGI60
" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFRUTORE

QARKU: FIER KOMUNA :CAKRAN Fshati:Vreshtas

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona	Nr.i	Pasurise	Shpr.m2	Kul.Bujq		Dru Frutore		Totali Lek	0
								Vlera Lek	Vlera Lek	Vlera Lek	Vlera Lek		
1	MYSTEHAH	MECAN	NAZERAJ	3828	274/1		2168	21463	0	0	0	21463	
2	SAMI	MECAN	NAZERAJ	3828	274/3		677	3732	0	0	0	3732	Konf.Z.R.P.P
3	GEZIM	HYSO	NAZERAJ	3828	274/6		612	6059	0	0	0	6059	Konf.Z.R.P.P
Shuma (leke)							3457	31254	0	0	0	31254	

Ministria e Puneve Publike, Transp. Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektor i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFRUTORE
QARKU: FIER KOMUNA :CAKRAN Fshati:Gjoc

Nr	Emert	Atesia	Mbiemri	Zona	Nr. i	Sip	Kul.Bujq	Dru Frutore	Shenime
			Kadastrale		Pasurise	Shpr.m2	Vlera Lek	Vlera Lek	Totali Lek
1	KOZMA	TAQI	STERJA	1758	240/1	1030	12870	0	12870
2	QEDERI	FASLLI	MUSARAJ	1758	5/1	1389	5556	0	5556
3	AGIM	NURCE	PASHAJ	1758	5/2	619	2476	0	2476
4	HASAN	NURCE	PASHAJ	1758	5/3	344	1376	0	1376
5	SHAQO	QERIM	COBAJ	1758	6/3	14	56	0	56
6	NURE	QERIM	COBAJ	1758	6/5	677	6702	0	6702
7	SHAQO	QERIM	COBAJ	1758	6/6	639	6326	72000	78326
8	HAXHI	OSMEN	RRAPI	1758	6/7	622	2488	0	2488
9	KOVAC	OSMEN	RRAPI	1758	6/8	408	1632	0	1632
10	ILIAZ	RRAPO	PASHAJ	1758	6/9	354	1416	0	1416
11	QAZIM	OSMEN	ARAPI	1758	6/11	1081	4324	0	4324
12	FATMIR	MUCO	SALIA	1758	18/1	268	1072	0	1072
13	FECORR		MYFTARI	1758	19/1	39	156	0	156
14	ASTRIT	MUCO	SALIA	1758	19/3	284	1136	0	1136
Shuma (Leke)						7768	47586	72000	119586

Ministria e Puneve Publike, Transp.Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektor i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFRUTORE
QARKU: FIER KOMUNA :CAKRAN Fshati:Gorishove

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona	Nr. i	Sip	Kul.Bujq	Dru Frutore	Totali Lek	Shenime
				Kadastrale	Pasurise	Shpr.m2	Vlera Lek	Vlera Lek		
1	Sefer	Liman	Alushi	1811	274/17	86	851	0	851	Konf.Z.R.P.P
2	Asqeri	Qermal	Alushi	1811	274/15	207	2049	0	2049	Konf.Z.R.P.P
3	Petrit	Qermal	Alushi	1811	274/14	86	851	0	851	Konf.Z.R.P.P
4	Pajtim	Dano	Mucaj	1811	274/9	89	881	0	881	Konf.Z.R.P.P
5	Jonuz	Petref	Mucaj	1811	274/8	432	4277	0	4277	Konf.Z.R.P.P
6	Refat	Riza	Beqaj	1811	274/7	260	2574	0	2574	Konf.Z.R.P.P
7	Ramiz	Riza	Beqaj	1811	274/4	307	3039	0	3039	Konf.Z.R.P.P
8	Gani	Riza	Beqaj	1811	274/3	394	3900	0	3900	Konf.Z.R.P.P
9	Xhemil	Riza	Beqaj	1811	274/2	347	3435	0	3435	Konf.Z.R.P.P
10	Rait	Riza	Beqaj	1811	274/1	363	3594	0	3594	Konf.Z.R.P.P
11	Ahmet	Isuf	Numani	1811	273/5	310	3069	0	3069	Konf.Z.R.P.P
12	Xhafo	Bari	Numani	1811	273/6	210	2079	0	2079	Konf.Z.R.P.P
13	Bajram	Isuf	Numani	1811	273/7	648	6415	0	6415	Konf.Z.R.P.P
14	Nexhip	Dervish	Kalemi	1811	273/10	252	2495	0	2495	Konf.Z.R.P.P
15	Nurjet	Sabri	Kalemi	1811	273/11	428	4237	0	4237	Konf.Z.R.P.P
16	Teki	Shefit	Sulkaj	1811	273/14	307	3039	0	3039	Konf.Z.R.P.P
17	Shefit	Muco	Sulkaj	1811	273/16	299	2960	0	2960	Konf.Z.R.P.P
18	Shpresim	Muco	Sulkaj	1811	273/17	472	4673	0	4673	Konf.Z.R.P.P
19	Osman	Tefik	Sulkaj	1811	273/18	237	948	0	948	Konf.Z.R.P.P
20	Tofik	Brahim	Sulkaj	1811	273/22	191	1891	0	1891	Konf.Z.R.P.P

21	Xhemal	Muhamet	Tafaj	1811	273/23	427	4227	0	4227	Konf.Z.R.P.P
22	Abaz	Muhamet	Tafaj	1811	273/24	310	3069	0	3069	Konf.Z.R.P.P
23	Tahir	Muhamet	Tafaj	1811	273/25	256	2534	0	2534	Konf.Z.R.P.P
24	Agur	Jaho	Tafaj	1811	273/26	330	3267	0	3267	Konf.Z.R.P.P
25	Bujar	Jaho	Tafaj	1811	273/27	341	3376	0	3376	Konf.Z.R.P.P
26	Agur	Mesut	Seitaj	1811	273/35	265	2623	0	2623	Konf.Z.R.P.P
27	Kujtim	Hasan	Seitaj	1811	273/36	239	287	0	287	Konf.Z.R.P.P
28	Qamil	Mesut	Seitaj	1811	273/37	251	301	0	301	Konf.Z.R.P.P
29	Luto	Hakim	Begaj	1811	239/1	287	2841	0	2841	Konf.Z.R.P.P
30	Shpetim	Hakim	Begaj	1811	239/2	82	98	0	98	Konf.Z.R.P.P
31	Agron	Hakim	Begaj	1811	239/3	470	564	0	564	Konf.Z.R.P.P
32	Petrit	Hakim	Begaj	1811	239/4	333	400	0	400	Konf.Z.R.P.P
33	Hasim	Harshi	Begaj	1811	239/6	324	3208	0	3208	Konf.Z.R.P.P
34	Resmi	Harshi	Begaj	1811	239/7	401	3970	0	3970	Konf.Z.R.P.P
35	Festim	Harshi	Begaj	1811	239/8	277	2742	0	2742	Konf.Z.R.P.P
36	Tahir	Hetem	Omeri	1811	239/12	355	3514	0	3514	Konf.Z.R.P.P
37	Hetem	Tahir	Omeri	1811	239/13	295	2920	0	2920	Konf.Z.R.P.P
38	Perparim	Haxhem	Kullara	1811	239/14	633	2970	59390	62360	Konf.Z.R.P.P
39	Telo	Jonuz	Bega	1811	239/16	260	2574	0	2574	Konf.Z.R.P.P
40	Myfit	Glysho	Bega	1811	239/18	318	3148	0	3148	Konf.Z.R.P.P
41	Adriatik	Faik	Bega	1811	239/19	335	3316	0	3316	Konf.Z.R.P.P
42	Burim	Bilbil	Merkaj	1811	239/25	354	3505	0	3505	Konf.Z.R.P.P
43	Agur	Seit	Seiti	1811	239/27	917	1000	0	1000	Konf.Z.R.P.P
44	Nexho	Ahmet	Seiti	1811	239/28	1086	5801	0	5801	Konf.Z.R.P.P
45	Bilbil	Sami	Seiti	1811	239/29	1432	11880	0	11880	Konf.Z.R.P.P
46	Sami	Ahmet	Seiti	1811	239/30	1376	6930	0	6930	Konf.Z.R.P.P
47	Bashkim	Demo	Seiti	1811	239/31	644	3405	0	3405	Konf.Z.R.P.P
Shuma (Leke)						18523	141727	59390	201117	

Ministria e Puneve Publike, Transp.Telekom.
Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese
Drejtoria Juridike
Sektor i Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

" LEVAN - TEPELENE" PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFRUTORE

